Provizionet njihen kur Shoqeria ka nje detyrim aktual (ligjor ose te terthorte) si rezultat i nje ngjarje ne te kaluaren dhe ka mundesi qe do te nevojitet nje fluks burimesh qe perfshin perfitimet ekonomike per te permbushur detyrimin dhe ne kete menyre mund te behet nje perilogaritje e besueshme e shumes se detyrimit. Ne rast se efekti eshte material, provizionet jane percaktuar duke skontuar flukset e pritshme te parase me normen e uljes para tatimeve, e cila reflekton vleren kohore te parase ne kushtet aktuale te tregut dhe, aty ku eshte e pershtatshme, normen e riskut te pasiveve specifike. Provizionet rishikohen ne çdo date bilanci dhe nese nuk ka me mundesi per nevojitjen e nje fluksi burimesh qe perfshin perfitimet ekonomike per shlyerjen e detyrimit, provizionet kthehen. Provizionet perdoren vetem per qellimin qe jane njohur fillimisht. Ato nuk njihen per humbjet e ardhshme operative. Aktivitet e kushtezuara nuk njihen.

3.9 Te ardhurat

3.9.1 Produktet e shitura

Te ardhurat nga shitja e mallrave jane matur me vleren e drejte te pagesave te arketuara ose te arketueshme, pakesuar me tatimet dhe taksat mbi shitjet. Te ardhurat nga shitja jane vleresuar me vleren e drejte te kompesimit te marre, neto nga kthimet, uljet tregtare, uljet mbi volumet dhe rabatat. E ardhura eshte njohur kur rreziqet dhe te drejtat mbi produktet i kalojne ne nje pjese te rendesishme bleresit, marrja e kompesimit eshte e mundshme, kostot e lidhura dhe kthimet e mundshme te mallrave mund te maten me besueshmeri dhe nuk ka me perfshirje te vazhdueshme te drejtimit te Shoqerise me keto produkte.

3.10 Pagesat e qirave

Kosto fikse te qerases per keto linja te lidhura shpenzohen ne baze te metodes lineare mbi kushtet e qerases. Shpenzimet e lindura nga qerate operative njihen ne pasqyren e te ardhurave ne baze te metodes lineare sipas kohezgjatjes se qerases.

3.11 Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Te ardhurat dhe shpenzimet nga interesat njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve kur akumulohen, duke marre parasysh metoden efektive te interesit.

Kosto neto te financimit perbejne interesin e pagueshem mbi borxhet e marra per qellime te kapitalit te punes, te perlloragatur me normen e interesit nominal dhe humbjet nga kursi i kembimit.

3.12 Tatim Fitimi

Tatim fitimi apo humbjet e vitit perbehen nga tatimi aktual dhe ai i shtyre. Tatim fitimi njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve pervec rasteve kur lidhet me zera qe njihen direkt ne kapital, rast ne te cilin edhe tatimi njihet ne kapital. Tatimi aktual eshte tatimi i pritur per t'u paguar mbi fitimin e tatueshem te vitit, duke aplikuar normat tatimore ne fuqi ne daten e bilancit, si edhe cfare doloj rregullimi kontabel te tatimit per t'u paguar ne lidhje me vitet e meparshme.

Tatimi i shtyre llogaritet duke perdorur metoden e bilancit kontabel, duke sjelle diferenca te perkohshme midis vleres kontabel te aktiveve dhe pasiveve per raportin financiar dhe vleres kontabel per qellime tatimi. Diferencat e perkohshme nuk parashikohen per njohjen fillestare te aktiveve dhe pasive qe nuk kane asnje ndikim mbi kontabilitetin apo fitimin e tatueshem. Shuma e tatimit te shtyre bazohet ne menyren e pritshme te realizimit apo shlyerjes se shumes se akumuluar te aktiveve dhe pasiveve, duke perdorur normat tatimore ne fuqi ne daten e bilancit.

Nje aktiv i detyrimit te shtyre njihet vetem nese ka te ngjare qe fitimet e ardhshme te tatueshme do te jene ne dispozicion, e ndaj te cilave aktiv i mund te perdoret. Aktivet e tatimit te shtyre reduktohen deri ne shkallen ku nuk eshte me e mundur qe te realizohet perfitimi perkates nga tatimi.

3.13 Standarde dhe interpretime te cilat priten te hyjne ne fuqi

Ne daten e miratimit te ketyre pasqyrave financiare, standardet, rishikimet dhe interpretimet e meposhtme jane miraturar por nuk kane hyre ende ne fuqi:

- SNRF 1. Adoptimi per here te pare i SNRF (ne vijim te nje ndryshimi ne dhjetor 2008, ne fuqi per pasqyrat e para financiare sipas SNRF per periudha qe fillojne me ose pas 1 korrikut 2009). SNRF i rishikuar ruan permbajtjen e versionit te tij te meparshem por, me ndryshime ne strukture per ta bere me te kuptueshem per lexuesin dhe per te bere me te lehte pershtatjen e ndryshimeve te ardhshme.
- Përmirësimi i Shënimeve Shpjeguese për Instrumentat Financiare – Ndryshim i SNRF 7. Instrumentat financiare: Shënimet shpjeguese (botuar në mars 2009; në fuqi për periudha që fillojnë më ose pas 1 janarit 2009). Ndryshimi kërkon përmirësim të shënimeve shpjeguese në lidhje me matjen e vlerës së drejtë dhe riskut të likuiditetit. Njësisë do t'i kërkohej të paraqesë një analizë të instrumentave financiare duke përdorur një hierarki matëse të vlerës së drejtë me tre nivele. Ndryshimi (a) sqaron se analiza e maturimit të detyrimeve duhet të përfshijë kontrata të garancisë financiare të lëshuara në masën maksimale të garancisë në periudhën më të hershme në të cilën kjo garanci mund të kërkohej; dhe (b)

kërkon shpjegime në lidhje me maturimet kontraktuale të derivativëve financiarë nëse maturimet kontraktuale janë esenciale për të kuptuar frekuencën kohore të flukseve monetare. Një njesie do t'i duhet të paraqesë një analizë të maturimit të aktiveve financiare që ajo mban për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit, në qoftë se informacioni është i nevojshëm për t'u mundësuar përdoruesve të pasqyrave financiare të vlerësojnë natyrën dhe shkallën e rrishtit të likuiditetit.

- SNRF për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM) (botuar në korrik 2009) është një standard më vehte , i përshtatur për nevojat dhe kapacitetet e bizneseve të vogla. Shumë nga parimet e SNRF-ve të plota për njohjen dhe matjen e aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpezimeve janë thjeshtëzuar dhe numri i dhënies së informacioneve shpjeguese është thjeshtëzuar dhe reduktuar në mënyrë të ndjeshme. SNRF-ja për NVM-të mund të zbatohet për njesitë që publikojnë pasqyrat financiare për qëllime të përgjithshme për përdoruesit e jashtëm dhe që nuk kanë përgjegjësi publike.

- Përfshirje Shtesë për Adoptimin për Herë të Parë – Ndryshime të SNRF 1. Adoptimi i IFRS për Herë të Parë (në fuqi për periudha që fillojnë më ose pas 1 janarit 2010). Ndryshimet përfshijnë njesitë që përdorin metodën e kostos së plotë nga zbatimi retrospektiv i SNRF-ve për pasuritë e naftës dhe gazit dhe përfshijnë gjithashtu njesitë me kontrata ekzistuese qiraje financiare nga rishqyrtimi i klasifikimit të atyre kontratave sipas IFRIC 4 'Përcaktimi Nëse një Marrëveshje Përmban një Qira' kur aplikimi i kërkesave të standardeve kombëtare të kontabilitetit prodhon të njëjtin rezultat.

- SNK 24. Shënime shpjeguese mbi palët të lidhura (ndryshuar në nëntor 2009, në fuqi për periudha që fillojnë më ose pas 1 janarit 2011). SNK 24 u rishikua në 2009 duke: (a) thjeshtëzuar përkufizimin e palëve të lidhura, duke qartësuar kuptimin e tij dhe duke eliminuar mospërputhjet me përkufizimin dhe (b) duke siguruar një përfshirje të pjesshme nga kërkesat për shënime shpjeguese për njesitë e lidhura shtetërore.

- IFRIC 17. Shpërndarja e Aktiveve Jo-monetare tek Pronarët (në fuqi për periudha që fillojnë më ose pas 1 korrikut 2009). Ndryshimi sqaron kur dhe si duhet të njihet shpërndarja e aseteve jo-monetare si dividend. Një njesi duhet të vlerësojë detyrimin për shpërndarjen e aseteve jo-monetare si dividendë duke përdorur vlerën e drejtë të aseteve për t'u shpërndarë. Një fitim ose humbje nga shitja e aseteve jo-monetare të shpërndara do të njihet si fitim ose humbje kur subjekti të përcaktojë dividendin e pagueshëm.

- Aktivet financiare kërkohet të klasifikohen në dy kategori matëse: ato që maten në vazhdim me vlerë të drejtë, dhe ato që maten në vazhdim me vlerë të amortizuar. Vendimi duhet marrë në momentin e njohjes fillestare. Klasifikimi varet nga modeli i vetë shoqërisë për menaxhimin e instrumentave financiare si dhe nga karakteristikat kontraktuale të flukseve monetare në lidhje me instrumentin.
 - Një instrument matet në menyrë të vazhdueshme me vlerë të amortizuar vetëm nëse është instrument borxhi dhe (i) synimi i modelit të biznesit të njësisë është të mbajë aktivin për të fituar mjete monetare që rrjedhin nga kontrata, dhe (ii) mjetet monetare që rrjedhin nga kontrata përfaqësojnë vetëm pagesa të principalit dhe interesit (pra, instrumenti ka "karakteristikat bazë të një huaje"). Të gjitha instrumentat e tjerë të borxhit duhet të maten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimeve apo humbjeve.
 - Të gjitha instrumentat e kapitalit duhet të maten në vazhdim me vlerë të drejtë. Instrumentat e kapitalit që mbahen për t'u tregtuar do të maten me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit apo humbjes. Për të gjitha investimet e tjera të kapitalit mund të bëhet një zgjedhje e pakthyeshme në momentin e njohjes fillestare për të njohur fitimet dhe humbjet e realizuara dhe të parrealizuara nga këmbimi nëpërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve gjithëpërfshirëse në vend të fitimeve dhe humbjeve. Nuk mund të kryhet riciklimi i të ardhurave ose humbjeve që rezultojnë nga matja me vlerë të drejtë në fitime ose humbje. Kjo zgjedhje mund të bëhet veçmas për çdo instrument. Dividendët do të paraqiten në fitime ose humbje për sa kohë që ata përfaqësojnë fitime nga investimi.
- Ndryshimet në SNRF 2 "Pagesat Nëpërmjet Aksioneve" – Transaksionet e pagesave ne para ne baze grupi nepermjet aksioneve (efektive per periudha qe fillojne me ose pas 1 janarit 2010).
 - Ndryshimet ne SNK 27 "Pasqyrat Financiare te Konsoliduara dhe Individuale" (efektive per periudha qe fillojne me ose pas 1 korrikut 2009).
 - Ndryshimet ne SNK 32 "Instrumentat Financiare: Paraqitja" – Trajtimi kontabel i emetimit te te drejtave (efektive per periudha qe fillojne me ose pas 1 shkurtit 2010).
 - KISNRF 19 "Shlyerja e Detyrimeve Financiare me Instrumentat e Kapitalit (efektive për periudha që fillojnë më ose pas 1 korrikut 2010). KISNRF sqaron trajtimin kontabel kur një njësi rinegocion kushtet e borxhit dhe rezulton që detyrimi shlyhet nëpërmjet emetimit të instrumentave të kapitalit nga debitori për kreditorin. Një fitim ose humbje njihet në pasqyrën e fitimeve dhe humbjeve mbi bazën e vlerës së drejtë të instrumentave kapitale krahasuar me vlerën kontabel neto të borxhit.
 - Parapagimet për Kërkesat e Financimeve Minimale - Ndryshim i KISNRF 14 (efektive për periudha që fillojnë më ose pas 1 janarit 2011). Ky ndryshim do të ketë një impakt të kufizuar meqenëse zbatohet vetëm nga shoqëritë që kërkohen të kryejnë kontribute financiare minimale në një plan pensioni të percaktuar. Ndryshimi heq një pasojë të padëshiruar të KISNRF 14 në lidhje me parapagesat e pensioneve vullnetare kur kërkohet një minimum financimi.

Shenimi 4 – Mjete monetare

	31 Dhjetor	
	2009	2008
	Leke	
Perberja		
Para ne dore	728.635	578.413
Para ne banka	33.690.160	284.112.484
	34.418.795	284.690.897

Likuiditetet e shoqerise "Albpetrol" sha ne fund te vitit 2009 paraqiten ne shumen 34.418.795 leke.

Shoqeria kryen transaksionet financiare nepermjet llogarive bankare ne leke dhe valute ne bankat :

- B.K.T.
- Raiffeisen Bank
- Pro Credit Bank
- Alpha Bank
- Tirane Bank
- Banka Credins
- Intesa San Paolo
- Banka nderkomtare tregtare
- U.B.A.
- Union Bank
- Emporiki Bank

Mjetet monetare ne valute te huaj jane vleresuar me kursin fiks te dates 31.12.2009 te shpallur nga Banka e Shqiperise dhe diferencat jane sistemuar ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Eshte bere rakordimi i gjendjes se llogarive te banka ne kontabilitet me gjendjen e ekstrateve bankare per secilen llogari dhe nuk ka diferenca. Jane rakorduar llogarite e arkes me gjendjen e librave te arkes per te gjitha njesite vartse dhe nuk ka diferenca.

Shenim 5 – Llogari tregtare te arketueshme

	31 Dhjetor	
	2009	2008
	Leke	
Perberja		
Llogari tregtare te arketueshm	12.143.700.019	9.533.425.074
	12.143.700.019	9.533.425.074

Gjendja e klienteve pasqyrohet si me poshte :

Albpetrol Sh.A.
Shenime te Pasqyrave Financiare
31 Dhjetor 2009

	31 Dhjetor	
	2009	2008
	Leke	
Armo sh.a.	10.436.904.556	7.870.614.243
UMN Kucove	310.690.626	309.730.626
UMN Patos	79.234.725	77.184.189
KESH	9.850.942	9.850.942
Subjekte Shteteror	321.252.124	324.828.810
Subjekte Private	985.767.046	941.216.264
	12.143.700.019	9.533.425.074

Shitjet me kliente shteterore e private jane realizuar me arketime te mevoneshme

Shenim 6 – Te tjera kerkesa te arketueshme

	31 Dhjetor	
	2009	2008
	Leke	
Perberja –		
Te tjera kerkesa per arketim	382.567.586	271.294.867
Debitore te ndryshem	70.950.114	74.004.134
V. me kapitalin sipas V.K.M.1665 date 17.12.2008	763.940.611	763.940.611
	1.217.458.311	1.109.239.612

Shenim 7 – Zhlveresimi

Maturimi i llogarive te arketueshme ne ditën e raportimit:

	31 Dhjetor 09		31 Dhjetor 08	
	Total	Provisioni per debitore te dyshimte	Total	Provisioni per debitore te dyshimte
Te pa maturuar	12.143.700.019	(227.664.223)	9.533.425.074	(228.032.361)
	12.143.700.019	(227,664.223)	9.533.425.074	(228,032.361)

Shenimi 8 - Inventari

	31 Dhjetor	
	2009	2008
	Leke	
Perberja –		
Lende te para	481.411.550	440.837.699
Prodhim ne proces	1.321.699	1.322.154
Produkte te gatshme	999.654.424	1.086.035.176
Mallra per rishitje	673.441.175	695.551.498
Provizione per zhvleresime	-17.060.426	-17.060.426
	2.138.768.422	2.206.686.101

Shoqeria nuk ka kryer zhvlefetesim te inventareve, me perjashtim te ish Servcomit i cili ka te trasheguar provizionin e mesiperm.

Shenimi 9 – Aktive Afatgjata Materiale

	Toka	Ndertesa	Makineri dhe pajisje	A. te tjera	TOTALI
	Leke	Leke	Leke	Leke	Leke
VLERA BRUTO AAM					
Gjendja me 1 Janar 2009	8.936.803.268	1.716.333.387	37.950.042.135	64.317.300	48.667.496.090
Shtesa gjate vitit	6.631.114.090	36.275.369	1.849.220.351	13.419.971	8.530.029.781
Pakesime gjate vitit	1.262.290.333	19.689.685	1.357.025.932	895.015	2.639.900.965
Gjendja me 31 Dhjetor 2009	14.305.627.025	1.732.919.071	38.442.236.554	76.842.256	54.557.624.906
AMORTIZIMI					
Gjendja me 1 Janar 2009	-	176.183.499	3.234.590.829	5.187.553	3.415.961.881
Shtesa gjate vitit	-	26.684.238	840.291.656	1.579.211	868.555.105
Pakesime gjate vitit	-	4.187.890	397.743.153	130.236	402.061.279
Gjendja me 31 Dhjetor 2009	-	198.679.847	3.677.139.332	6.636.528	3.882.455.707
VLERA NETO AAM					
Gjendja neto me 1 Janar 2009	8.936.803.268	1.540.149.888	34.715.451.306	59.129.747	45.251.534.209
Gjendja neto me 31 Dhjetor 2009	14.305.627.025	1.534.239.224	34.765.097.222	70.205.728	50.675.169.199
VLERA BRUTO AAM					
Gjendja me 1 Janar 2008	9.005.152.593	1.507.733.580	38.068.101.711	54.889.592	48.635.877.476
Shtesa gjate vitit	83.400.000	218.923.803	2.887.346.822	15.986.882	3.205.657.507
Pakesime gjate vitit	151.749.325	10.323.996	3.005.406.398	6.559.174	3.174.038.893
Gjendja me 31 Dhjetor 2008	8.936.803.268	1.716.333.387	37.950.042.135	64.317.300	48.667.496.090
AMORTIZIMI					
Gjendja me 1 Janar 2008	-	157.078.274	2.778.620.423	6.692.713	2.942.391.410
Shtesa gjate vitit	-	25.904.266	609.940.005	1.391.586	637.235.857
Pakesime gjate vitit	-	6.799.041	153.969.599	2.896.746	163.665.386
Gjendja me 31 Dhjetor 2008	-	176.183.499	3.234.590.829	5.187.553	3.415.961.881
VLERA NETO AAM					
Gjendja neto me 1 Janar 2008	9.005.152.593	1.350.655.306	35.289.481.288	48.196.879	45.693.486.066
Gjendja neto me 31 Dhjetor 2008	8.936.803.268	1.540.149.888	34.715.451.306	59.129.747	45.251.534.209

AAM jane njohur ne kontabilitet me koston e blerjes se tyre dhe shoqeria ka zgjedhur si politike te saj kontabile modelin e koston ku cdo element i AAM paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar. Shoqeria nuk ka akumuluar as nje humbje nga zhvlersimi. Normat e amortizimit te zbatuara jane ato te percaktuara ne vendimin e Keshillit Mbikeqyres dhe jo normat fiskale te percaktuara ne Ligjin nr.8438, date 28.12.1998 "Per tatimin mbj te ardhurat".

Shoqeria gjate vitit 2009 ka bere rivleresimin e truallit te saj, raportet e rivleresimi jane prane shoqerise ne Patos dhe diferencat e rivleresimit jane pefshire ne kontabilitet.

Shenimi 10 – Aktivet Afatgjata Jomateriale

	Te tjera te paprekshme Leke	Marka tregtare Leke	TOTALI Leke
VLERA BRUTO AAJM			
Gjendja me 1 Janar 2009	131.857.322	-	131.857.322
Shtesa gjate vitit	-	-	-
Pakesime gjate vitit			
Gjendja me 31 Dhjetor 2009	131.857.322	-	131.857.322
AMORTIZIMI			
Gjendja me 1 Janar 2009	110.680.393	-	110.680.393
Amortizimi vjetor	13.185.732	-	13.185.732
Zvogelimi nga nxjerrjet jashte perdorimit			
Gjendja me 31 Dhjetor 2009	123.866.125		123.866.125
VLERA NETO AAJM			
Gjendja neto me 1 Janar 2009	21.176.929		21.176.929
Gjendja neto me 31 Dhjetor 2009	7.991.197		7.991.197

Shenimi 11 – Aktivet te tjera Afatgjata

	Aktive ne process Pagesa pjesore Leke	Banesat e punonjesve Leke	TOTALI Leke
VLERA BRUTO AAM			
Gjendja me 1 Janar 2009	758.992.314	266.750.203	1.025.742.517
Shtesa gjate vitit	401.879.138	-	401.879.138
Pakesime gjate vitit	189.243.171	-	189.243.171
Gjendja me 31 Dhjetor 2009	971.628.281	266.750.203	1.238.378.484

Albpetrol Sh.A.
Shenime te Pasqyrave Financiare
31 Dhjetor 2009

AMORTIZIMI			
Gjendja me 1 Janar 2009	-	-	-
Amortizimi vjetor	-	-	-
Amortizime te ardhura nga transferimet	21.585.820	-	-
Gjendja me 31 Dhjetor 2009	21.585.820	-	-

VLERA NETO AAM			
Gjendja neto me 1 Janar 2008	758.992.314	266.750.203	1.025.742.517
Gjendja neto me 31 Dhjetor 2008	950.042.461	266.750.203	1.216.792.664

Shenimi 12 – Huamarrjet

	31 Dhjetor	
	2009	2008
	Leke	
Perberja		
Hua ndaj bankes	150.000.000	11.000.000
		-
	150.000.000	11.000.000

Shenimi 13 – Detyrime te pagueshme

	31 Dhjetor	
	2009	2008
	Leke	
Perberja		
Furnitore	8.250.109.705	6.800.497.344
Deftesa te pagueshme		-
	8.250.109.705	6.800.497.344

Gjendja e furnitoreve pasqyrohet si me poshte

	31 Dhjetor	
	2009	2008
	Leke	
Armo sh.a.	6.150.045.433	5.739.102.181
UMN Kucove	320.444.431	300.641.592
KESH	714.888.185	371.164.155
Subjekte Shteteror	142.446.334	43.536.414
Subjekte Private	922.285.322	346.053.002
	8.250.109.705	6.800.497.344

Shenimi 14 – Detyrime te pagueshme ndaj punonjesve

	31 Dhjetor	
	2009	2008
	Leke	
Perberja		
Te pagueshme ndaj punonjesve	166.006.347	108.957.095
	<u>166.006.347</u>	<u>108.957.095</u>

Shenimi 15 – Detyrime te tjera dhe gjendjet kreditore

	31 Dhjetor	
	2009	2008
	Leke	
Tatim mbi te ardhurat personale	53.854.300	17.812.503
TVSH-ja e pagueshme	196.842.089	111.956.449
Tatime taksa te tjera	-26.515.167	-10.041.797
Sigurime shoqerore	91.703.309	33.697.181
Tatim fitimi	65.226.734	-23.642.434
Renta hidrokarbure	90.072.409	224.096
Tatim pasurie	<u>10.219.383</u>	<u>9.818.213</u>
	481.403.057	139.824.211

Shenimi 16 – Detyrime te tjera dhe gjendjet kreditore

	31 Dhjetor	
	2009	2008
	Leke	
Perberja		
Huara te tjera	148.188.112	351.996.613
	<u>148.188.112</u>	<u>351.996.613</u>

Nga ate cilat 111.436.503 leke jane dividend per tu paguar, dhe 36.751.609 leke detyrime te tjera.

Shenimi 17 – Grante dhe te ardhura te shtyra

	31 Dhjetor	
	2009	2008
	Leke	
Perberja		
Grantet	126.430.626	125.298.789
	126.430.626	125.298.789

Grantet jane njohur pasi ka siguri te mjaftueshme qe permbushen kushtet e percaktuara ne lidhje me grantet dhe grantet do te merren /perfitohen. Grantet jane njohur ne te ardhurat ne menyre sistematike gjate periudhes kontabel. Rritja neto e tyre per vitin 2009 eshte 1.131.837 leke.

Shenimi 18 - Provizione

	31 Dhjetor	
	2009	2008
	Leke	
Perberja		
Provizione	15.000.000	15.000.000
	15.000.000	15.000.000

Shenimi 19 - Detyrime afatgjata

19.1 Perberja e detyrimeve afatgjata

	31 Dhjetor	
	2009	2008
	Leke	
Perberja		
Hua.bono dhe detyrime nga qeraja financiare	153.665.057	137.840.546
	153.665.057	137.840.546

19.2 Datat e maturimit te detyrimeve afatgjata

	31 Dhjetor	
	2009	2008
	Leke	
Viti i dyte	-	-
Viti i trete	-	-
Viti i katert	-	-
Viti i peste	-	-
Me tej	153.665.057	137.840.546

Albpetrol Sh.A.
Shenime te Pasqyrave Financiare
31 Dhjetor 2009

Huara nga bankat pasqyrohet me 31.12.2009 ne vleren 145.278.927 leke per Kredine Italiane te akorduar ne lireta dhe te konvertuar ne euro e administruar nga Banka Kombetare Tregtare.Shuma e paraqitur ne fund te vitit 2009 eshte rivleresuar me kursin e dates 31.12.2009; si dhe huara nga banka ne QShNG Patos(ish Servcomi) ne vleren 8.386.130 leke.

Shenimi 20 – Huamarrje te tjera afatgjata(kundraparti)

	31 Dhjetor	
	2009	2008
	Leke	
Perberja		
K/parti e vleres se banesave te punonjesve	266.750.203	266.750.203
K/parti e vleres se AAM jo ne shfrytezim te Transnaftes Patos	99.009.456	99.009.456
	365.759.659	365.759.659

Shenimi 21- Kapitali aksionar

	31 Dhjetor	
	2009	2008
	Leke	
Perberja		
Kapitali i autorizuar. i leshuar & Plotesisht i paguar.	10.406.529.000	10.193.877.000
Vlera nominale e çdo aksioni	1.000	1.000

<i>Emri i Aksionerit</i>	<i>Numri i pjeseve</i>	<i>Pergjindja e aksionit</i>	<i>Vlera e aksioneve</i>
MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGITIKES	10.406.529	100 %	10.406.529.000
Total	10.406.529	100 %	10.406.529.000

Kapitali aksionar ka ndryshuar si vlere dhe si numer aksionesh ne fund te vitit . Gjate vitit eshte bere rritja e kapitalit per vleren 214.745.000 leke(perthithja e IshServcomit dhe Transnafta) dhe zvogeluar per shumen 2.093.000 leke zvogelim kapitali per distributorin e shperndarjes se karburantit(Q.T.M.N.Patos).Vlera nominale e nje aksioni nuk ka ndryshuar ajo eshte 1.000 lek/aksioni.

Shenimi 22- K.P.R.H. I ish Servcom e Trasnafta

	31 Dhjetor	
	2009	2008
	Leke	
Perberja		
Ish Servcomi	-	208.307.900
Kapitali aksionar	-	396.648.000
Prime te lidhura me kapitalin	-	23.362.631
Rezerva	-	7.921.269
Humbje te mbartura	-	-219.624.000
Transnafta	-	12.341.142
Kapitali aksionar	-	74.630.000
Prime te lidhura me kapitalin	-	38.257.594
Rezerva	-	-
Humbje te mbartura	-	-100.546.452
	-	220.649.042

Ne krahasim me vitin e kaluar eshte zvogeluar per shumat 214.745.000 leke rritje kapitali dhe 5.904.042 leke pasqyruar ne paksim te aam per sipërfaqen e tokes te QSHPNG Kucove kaluar bashkise se Kucoves.

Shenimi 23- Primi I aksionit

	31 Dhjetor	
	2009	2008
	Leke	
Perberja		
Primi I aksionit	14.046.688.275	8.160.949.490
	14.046.688.275	8.160.949.490

Primet e lidhura me kapitalin me 31.12.2009 paraqiten ne vleren 14.046.688.275 leke , ndryshuar ne krahasim me vitin e kaluar ne vleren 5.885.738.785 leke pasqyruar rivleresimi i trojeve i kryer me 31.12.2009.

Shenimi 24- Rezerva ligjore

	31 Dhjetor	
	2009	2008
	Leke	
Perberja		
Rezerva ligjore	102.404.968	61.497.790
	102.404.968	61.497.790

Rezerva ligjore ne 31.12.2009 paraqitet ne shumen 102.404.968 leke ku ne krahasim me vitin e kaluar jane rritur nga shperndarja e fitimit te ushtrimit 2008 ne vleren 40.907.178 leke.

Shenimi 25- Rezerva te tjera

	31 Dhjetor	
	2009	2008
	Leke	
Perberja		
Rezerva te tjera	1.662.146.599	966.725.213
Diferenca nga rivleresimi	30.726.456.086	30.726.446.630
	32.388.602.685	31.693.171.843

Rezerva te tjera ne 31.12.2009 paraqitet ne shumen 1.662.146.599 leke ku ne krahasim me vitin e kaluar jane rritur nga shperndarja e fitimit te ushtrimit 2008 ne vleren 695.421.386 leke.

Diferenca nga rivleresimi me 31.12.2009 paraqiten ne vleren 30.726.456.086 leke te cilat ne krahasim me vitin e kaluar jane rritur ne vleren 9.456 leke. Ne to perfshihen diferencat pozitive dhe negative te rivleresimit te AQT-ve rezultuar nga procesi i rivleresimit i autorizuar me VKM Nr.201,date 07.04.2005 me sistemimet e kryera nga njesite e shoqerise Albpetrol sh.a. gjate viteve.

Shenimi 26- Fitim I vitit financiar

	31 Dhjetor	
	2009	2008
	Leke	
Perberja		
Fitimi i vitit financiar	405.846.893	818.143.556
	405.846.893	818.143.556

Fitimi i vitit ushtrimor 2009 rezultoi 554.206.214 leke, tatim fitimi i periudhes 148.359.321 leke sipas fitimit kontabel te shoqerise dhe i axhustuar me shpenzimet e panjohura per efekte fiskale. Fitimi neto i periudhes pasqyrohet ne vleren 405.846.893 leke.

Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve

Te ardhurat

	31 Dhjetor	
	2009	2008
	Leke	
Perberja		
Shitjet neto	6.025.484.866	6.935.683.381
Te ardhura te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit	1.026.453.182	241.352.734
Ndryshimet ne inventarin e produktit te gatshem e ne proces	-86.381.207	477.359.869
Puna e kryer nga njesia per qellimet e veta dhe e kapitalizuar	12.575.203	30.761.253
	6.978.132.044	7.685.157.237

Shpenzimet operative

	31 Dhjetor	
	2009	2008
	Leke	
Perberja		
Lendet e para, mallrat dhe sherbimet	-933.088.152	-1.158.298.278
Shpenzime te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit	-2.118.995.550	-849.111.193
Shpenzime te personelit	-2.963.359.829	-4.187.226.378
Pagat	-2.629.520.573	-3.780.126.828
Shpenzimet e sigurimeve shoqerore	-333.839.256	-407.099.550
Shpenzimet per pensionet	0	0
Renia ne vlere (zhvleresimi) dhe amortizimi	-510.481.023	-586.871.544
	-6.525.924.554	-6.781.507.393

Te ardhura (shpenzime) financiare, neto

	31 Dhjetor	
	2009	2008
	Leke	
Perberja		
Te ardhura financiare		
Te ardhura nga interesat		7,214.621
Te ardhurat nga kursi i kembimit	110.385.176	28.319.754
Shpenzime financiare:	-8.386.452	
Shpenzime interesi		
Shpenzime komisioni		
Humbje neto nga kembimi		
Total shpenzime financiare	-8.386.452	
Kosto financiare, neto	101.998.724	35.534.375

